



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 104, datë 19.10.2022

PËR

MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN NR. 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA "LURA", PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATET NR.15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019" I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë" të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit me nr. 471/52 Prot., datë 17.10.2022 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetar i bashkisë, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e disa shtesave në Aneksin 1, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, L.17, Rruga "Lura", pallatet nr.1&3, dhe Rruga "Ahmet Dakli", pallatet nr.15&23, Njësia Administrative Nr.5, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019” i ndryshuar, sipas tabelës si më poshtë vijon:


Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS	STRUKTURA E APARTAMENTIT, QË DO PËRFITOHET
112	RAMIZ SHABA + NEXHMIJE SHABA	3	2+1
113	VALENTINA SHTAMARI + JULIANA SHTAMARI + OGERTA DHAMO	2	1+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 20.10.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 8/8 prot

Durrës, më 26.10.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.104 datë 19.10.2022 :

Për miratimin e disa shtesave në aneksin nr 1, bashkëlidhur VKB Nr 32 dt 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për katër banesa kolektive, L.17 Rruga “Lura”, pallatet nr 1 dhe 3, dhe rruga “Ahmet Dakli” pallatet nr 15 dhe 23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019” i ndryshuar.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI